



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 424/30 Prot

Tiranë, më 30.09.2017

V E N D I M

Nr. 141, Datë 30.09.2017

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSMË TË DOGANAVE
“MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25, dhe 30 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi”, sipas programit të auditimit nr. 424/1 prot., datë 28.04.2017, ndryshuar me shkresën nr. 424/2 prot., datë 07.06.2017, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datë 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e të ardhurave dhe shpenzimeve (ISSAI 4100¹). Sipas ISSAI 4100, objektivi i audituesve në një auditim të përputhshmërisë, është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur për një çështje specifike, është në përputhje në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Nga auditimi i përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave, për sa i takon shkallës së ndjekjes të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale:

Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe “Evidencës së të Ardhurave Fiskale për periudhën Dhjetor 2016” të mbajtur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degës së Thesarit Tiranë, konstatohet se llogaria 470 “Llogari në pritje të ardhura doganore për t’u marrë”, e cila pasqyron gjendjen e mjeteve monetare të parapaguara nga subjektet tatimpagueses për shlyerjen e detyrimeve të ardhshme në mbyllje të vitit ushtrimor 2016, rezulton me **gjendje kreditore në vlerën 92,898,851 lekë**. Referuar të dhënave të Sistemi Elektronik Doganor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, kjo llogari rezulton me **gjendje kreditore në vlerën 1,128,333,275 lekë**, pra me një **diferencë më shumë për 1,035,434,424 lekë** se kontabiliteti dhe njëkohësisht edhe Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Si rrjedhojë, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2016, zëri 4322 “Operacione me shtetin” (në të cilën përfshihet edhe llogaria 470) në pasqyrën e aktiveve të bilancit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, njëkohësisht dhe në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) **nuk japin një pamje të drejtë të pozicionit financiar në vlerën 1,035,434,424 lekë**.

Konkluzion/Opinion

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e një opinionit të pakualifikuar me rezervë²**.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 470 “Llogari në pritje të ardhura për t’u marrë”, e cila pasqyron gjendjen e mjeteve monetare të parapaguara nga subjektet tatimpagueses për shlyerjen e detyrimeve të ardhshme dhe përfshihet në zërin 4342 “Të tjera operacione me shtetin” të Aktivit të Bilancit të DPD-së ka rezultuar si më poshtë vijon:

¹ *ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

² *Opinionit i pakualifikuar me rezervë. - Jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve.*

Referuar “Evidencës së të Ardhurave Fiskale për periudhën Dhjetor 2016” të mbajtur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degës së Thesarit Tiranë, konfirmohet se në mbyllje të vitit ushtrimor 2016, llogaria 470 “Llogari në pritje të ardhura doganore për t’u marrë”, rezulton me **gjendje kreditore 92,898,851 lekë**, ndërkohë që referuar Sistemit Asycuda, kjo llogari rezulton me **gjendje kreditore 1,128,333,275 lekë**, pra me një diferencë më shumë në vlerën 1,035,434,424 lekë në krahasim me kontabilitetin dhe Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë. Si rrjedhojë në mbyllje të periudhës ushtrimore 2016, zëri 4322 “Operacione me shtetin” (në të cilën përfshihet llogaria 470) në bilancin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, njëkohësisht dhe në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) **paraqiten me diferencë në vlerën 1,035,434,424 lekë**.

Nga auditimi rezultoi se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2016, llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor”, në Aktivin e Bilancit të Aparatit të DPD-së, rezulton **në vlerën 1,940,914,780 lekë**. Nga mbledhja e nënzërave që përfshihen në këtë llogari, konstatohet se llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitorë” rezulton **në vlerën 1,942,306,507 lekë**, pra **me diferencë në vlerë për 1,391,728 lekë**. Si rrjedhojë edhe llogaria 71 “Të ardhura financim i pritshëm nga buxheti” në pasqyrën e të ardhurave të Aparatit të DPD-së nuk paraqet vlerën reale. Nga auditimi rezultoi se ekziston një diferencë në vlerën 4,473 mijë lekë më shumë midis të ardhurave të deklaruara në SIFQ dhe pasqyrave financiare të DPD-së, e cila përfaqëson të ardhura të tjera doganore nga taksa dhe transaksione ndërkombëtare, veprime që kryhen nëpërmjet SIFQ por jashtë sistemit informatikë doganor . *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, bazuar në Standardet e Kontabilitetit Publik ose praktikat më të mira, të marrë të gjitha masat për korrigjimin e situatës së krijuar në bilancin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, njëkohësisht edhe në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë duke dhënë informacion shpjegues në lidhje me situatën e krijuar. Njëkohësisht të nxjerrë edhe përgjegjësitë në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin besnikërisht pozicionin financiar dhe performancën financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

1.2. Rekomandimi: Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë të gjitha masat për nxjerrjen e një udhëzimi nëpërmjet të cilit të saktësohet mënyra e rakordimit të të dhënave të dy sistemeve (kontabilitetit buxhetor Alfa dhe sistemit Asycuda), me qëllim parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen të cilat ndikojnë negativisht në Treguesit Fiskal të Buxhetit të Konsoliduar.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, të ardhurat doganore janë realizuar në vlerë **148,427 milion lekë**, nga **155,099 milion lekë** të planifikuara me Ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, ose në masën **95,7%**, me një mosrealizim në vlerën **6,663 milion lekë**.

Nga auditimi sipas llojit të të ardhurave doganore rezultoi se, të ardhurat nga taksa doganore janë realizuar në vlerën 6,135 milion lekë, nga 6,036 milion lekë të planifikuara, ose në masën 101.6%, me një tejkalim në vlerën 99 milion lekë. Të ardhurat nga TVSH, janë realizuar në vlerën 97,593 milion nga 100,301 milion lekë të planifikuara, ose me në masën 97.3 %, me një mosrealizim në vlerën 2,708 milion lekë. Të ardhurat nga Akciza janë realizuar në vlerën 41,895 milion lekë, nga 44,653 milion lekë të planifikuara ose në masën 93.8 %, më një mosrealizim në vlerën 2,758 milion lekë. Të ardhurat nga Taksat nacionale (Renta minerare) janë realizuar në vlerën 2,804 milion lekë,

nga 4,100 milion lekë të planifikuara ose në masën 68.4 %, më një mosrealizim në vlerën 1,296 milion lekë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 90-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë një analizë të detajuar të aktivitetit operacional në drejtim të realizimit sipas zërave të të ardhurave doganore, për të mundësuar marrjen e masave për të përmirësuar treguesit, kryesisht për zërat e të ardhurave që rezultojnë me mosrealizim.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018, u konstatua se, në shumë produkte të programit, ka ndryshime të theksuara në vlerë nga njëra fazë në tjetrën, pavarësisht se sasia e produkteve nuk ndryshon. Për programin “Menaxhimi i të Ardhurave Doganore”, në fillim të vitit janë çelur 9 projekte investimi, në vlerë 160,000 mijë lekë, ndërsa plani me ndryshime ka rezultuar për 12 projekte investimi në vlerë 153,284 mijë lekë. Pra, ekzistojnë disa produkte të cilat janë raportuar në projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018, faza e I-rë, por që mungojnë në Dokumentin e Rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018, faza e II-të si dhe anasjelltas, gjë e cila vë në dyshim standardet dhe vërtetësinë e programimit të produkteve. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 123-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Ekipi i Menaxhimit të këtij programi si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në zbatim të Ligjit organik të buxhetit, Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave duhet të hartojë një programim të kujdesshëm të objektivave/produkteve në mënyrë që të sjellin kërkesa buxhetore të qarta dhe programim të kujdesshëm të fondeve buxhetore si në kuadër të buxhetimit afatmesëm dhe atë vjetor, duke realizuar në këtë mënyrë inkurajimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomikitet të shpenzimeve publike.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit, në zbatim të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, rezultoi se nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit lidhur me riskun dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik, pasi nuk është hartuar Strategjia e Riskut si dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka funksionuar rregullisht për evidentimin dhe vlerësimin e risqeve e reja. Titullari i institucionit nuk e ka luajtur rolin e koordinatorit të riskut dhe nuk e ka deleguar këtë kompetencë. Nuk janë miratuara rregulla të brendshme për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe nuk janë kryer kontrole shtesë për minimizimin e riskut. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 108-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit, të marrë masa për vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e riskut duke rritur efektivitetin e sistemit të kontrollit me qëllim përmbushjen e objektivave kryesore institucionale.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore, u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përgjatë vitit 2016, ka likuiduar vlerën 213,439

mijë lekë, duke krijuar një efekt negativ në buxhetin e shtetit, nga të cilat 81 raste për ish punonjës në vlerën 78,688 mijë lekë dhe 21 raste shoqëritë tregtare në vlerën 134,753 mijë lekë. Këto shpenzime përfaqësojnë 6,3% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për vitin 2016. U konstatua se, në disa raste nuk është bërë likuidimi sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre, si dhe nuk është publikuar grafiku i likuidimit të tyre në faqen zyrtare on-line të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 numri i vendeve të punës vakant në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, rezulton të jetë 55 nëpunës. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 138-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore dhe administrative ndaj personave shkaktarë të cilët kanë krijuar detyrimin në vlerën **213,439 mijë lekë** për vendimet gjyqësore, duke ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit.

Të zbatojë me përpikmëri të gjitha procedurat e njohura ligjore me qëllim që të shmangen efektet financiare në buxhet të krijuara nga zhvillimi i proceseve gjyqësore.

Të marrë masat e nevojshme që, ekzekutimet e Vendimeve Gjyqësore të bëhen sipas legjislacioni në fuqi, duke i publikuar në faqet zyrtare, apo në një formë tjetër publikimi të grafikut të shlyerjes së tyre duke respektuar radhën e paraqitjes së tyre zyrtare.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, duhet të marrë të gjitha masat për plotësimin e vendeve vakante të punës me punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit, me qëllim plotësimin e strukturës dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transaksioneve monetare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u konstatua se, me urdhër pagese nr. 343, datë 19.05.2016, është bërë likuidimi i interesave për mosshlyerjen në kohë të detyrimeve për taksën e qarkullimit, taksën e karbonit, dhe taksën e ambalazhit **në vlerën 1,761 mijë lekë**, me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Megjithëse nga strukturat drejtuese janë bërë përpjekje për rimbursimin e kësaj vlere, deri në mbyllje të periudhës ushtrimore 2016, në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nuk është bërë e mundur rimbursimi i saj. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 141-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të ndjekin të gjithë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës së interesave për mosshlyerjen në kohë të taksës së qarkullimit, taksës së karbonit dhe taksën e ambalazhit, **në vlerën 1,761 mijë lekë**, në të kundërt të nxjerrë përgjegjësitë ligjore dhe administrative ndaj personave shkaktarë të dëmit të krijuar.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të aseteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rezultoi:

Në dokumentacionin e fletë hyrjeve të mallit në magazinë u konstatua se në një numër të konsiderueshëm të tyre është plotësuar me laps kolona e çmimit dhe e vlerës, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 36, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në dosjen e inventarizimit të magazinës parku i automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u konstatua se kryetari i komisionit të inventarizimit, nuk ka firmosur në inventarin e kryer, për rrjedhojë inventari është aprovuar nga 2 punonjës, duke cënuar procesin për shkak të pamundësisë së një vendimmarrjeje të drejtë.

Komisionet e posaçme në asnjë rast nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjës material, para fillimit të inventarit me qëllim fiksimit të numrit rendor të flete hyrjeve dhe të fletëve daljeve si dhe nuk kanë përpiluar një raport për Nëpunësin Autorizues, lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre dhe gjendjen fizike të aktiveve, në kundërshtim me pikën 82, 83 dhe 85 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 143-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa që dokumentacioni i fletëhyrjeve dhe daljeve të magazinës të hartohet me përgjegjësi me qëllim që ti japë dokumentacionit forcën e një prove ligjore dhe administrative.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa që procesi i inventarizimit të kryhet dhe monitorohet me kujdes, në mënyrë që ky proces të konsiderohet si një proces kontrolli dhe vlerësimi për pronën e institucionit. Mungesat e çdo anëtari të komisionit të inventarizimit duhet të bëhen shkak për ndërprerjen e procesit deri në zëvendësimin e personit që nuk ka mundësi të marrë pjesë në finalizimin e inventarizimit, me qëllim ndërprerjen e praktikave formale në realizimin e procedurave dokumentare.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borxhit doganor u konstatua se detyrimet e pambledhura në fund të vitit 2016 janë në vlerën 24,787,915 mijë lekë, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur në total për shumën 3,330,433 mijë lekë ose në masën 13.4%. Në totalin e borxhit detyrimet doganor rezultojnë në vlerën 6,750,592 mijë lekë, ose 27% e totalit të borxhit, gjërat janë në vlerën 15,135,112 mijë lekë ose 61% dhe kamatëvonesat në vlerën 2,902,211 mijë lekë ose 12% të totalit të borxhit. Gjatë vitit ushtrimor 2016, borxhi është shtuar me 4,400,549 mijë lekë, për 3,463 raste subjektsh debitorë, dhe është pakësuar me 1,070,106 mijë lekë për 3,557 raste subjektsh debitorë. Tendencat e borxhit doganor në vitin 2016 si raport i pakësimit kundrejt shtesës gjatë vitit është në masën 44.08% më shumë rritje borxhi doganor dhe borxh akcize. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 101-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Sektori i Rikuperimit me Forcë të Borxhit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në bashkëpunim me Degët Doganore, të bëjë një analizë të thelluar të rasteve të shtuara të mosarkëtimit të borxhit dhe rrugëve të zgjidhjes për rikuperimin e këtyre detyrimeve. Borxhi i lindur si rezultat i shkeljeve të legjislacionit të akcizës të analizohet sipas natyrës së lindjes së detyrimeve me qëllim parandalimin në të ardhmen.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me programin e kontrollin nr. 1252, datë 18.01.2016 për subjektin “K W” me nipt, nga ana e Departamentit të Akcizës është përpiluar relacioni nr. 1251/2 prot datë 09.05.2016 në vijim të të cilit inspektorët e kontrollit janë njohur me faktet e reja dhe kanë depozituar relacionin. Dega e Doganës Durrës pas rishqyrtimit të

relacionit të Departamentit të Akcizës, ka nxjerrë vendimet administrative nr. 653 dhe nr. 654 datë 20.10.2016, pa verifikuar më parë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve faturën nr. 01, datë 30.12.2014 për sasinë 8000 litra lëng rrushi, e cila është ngarkuar në sistemin e magazinës fiskale nga subjekti “K W” përpara datës së ushtrimit të kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 61-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Departamenti i Akcizës të kërkojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve verifikimin e faturës tatimore nr. 01 datë 30.12.2014, në sasinë prej 8,000 litra lëng rrushi e cila rezulton e ngarkuar në sistemin e magazinës fiskale nga subjekti “K W” me NIPT, përpara datës së ushtrimit të kontrollit me qëllim vjeljen dhe arkëtimin e gjithë detyrimeve të mundshme doganore të akcizës, të cilat do të rezultojnë në mungesë pas këtij verifikimi.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor, për fondet publike të alokuara viti 2016, ka hartuar dhe dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik “Regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe autoriteteve të vartësisë për vitin 2016” me fond limit në vlerë 1,866,778 mijë lekë. Shpenzimet operative llogaria (602) për mallra e shërbime janë alokuar me vlerë fillestare 1,970,278 mijë lekë, ndërsa gjatë periudhës me aktin normativ nr. 1, datë 20.07.2016 janë ndryshuar duke rezultuar në vlerën përfundimtare 2,052,607 mijë lekë. Shpenzimet për investime, llogaria (230-231) janë alokuar me vlerë fillestare 663,879 mijë lekë dhe gjatë vitit, janë rishikuar, duke rezultuar në vlerën përfundimtare 525,607 mijë lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të tenderave të zhvilluar rezultoi se përllogaritja e fondit limit në rastet kur është bazuar në kontratat e mëparshme, nuk është argumentuar me dokumentacion përkatës. Nga grupet e punës në hartimin e procesverbalit nuk ka gjurmë për kryerje të veprimeve aritmetike për përllogaritjen e fondit limit të njoftimit të kontratës, si minimale, mesatare apo maksimale, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 12, neni 41 dhe nenin 10 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.

Për procedurat e prokurimit me objekt blerje pjesë këmbimi për mjete transporti dhe mirëmbajtje, grupet e punës në përllogaritjen e vlerës limit, nuk kanë pasqyruar me argumente e analizë të hollësishme, sasinë e kilometrave që kanë përshkruar mjetet gjatë vitit paraardhës, normativën e konsumit për 100/km të mjeteve, gjendjen teknike të çdo mjeti, veprime këto, jo në përputhje me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 pika 2 dhe nenin 9 të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 146-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masat që, për tenderat me natyrë dhe objekt të njëjtë, të realizojë procedura tenderuese në përputhje me bazën ligjore të prokurimit publik në hartimin e fondit limit, në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në hartimin e kërkesave kualifikuese, në ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke sjellë një efikasitet të plotë të fondeve publike, në arritjen e objektivave të këtij institucioni.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se janë deklaruar mallra të përjashtuara nga detyrimet doganore të TVSh-së në shumën 3,195,478 për mallra të natyrës “filtra” “lubrifikante”,

“gjilpëra makinash”, “radio marrëse” në zbatim të ligjit nr. 125/2012 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, por këto deklarime doganore rezultojnë në mospërputhje të përcaktimeve të Ligjit nr. 9461 datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore” i ndryshuar. Gjithashtu nuk janë kryer veprime verifikuese konkrete në ambientet e subjekteve deklarues që kanë përfituar përjashtime nga detyrimet e TVSH-së, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë faktike të gjendjes fizike të këtyre mallrave të përjashtuara nga detyrimet doganore të TVSH-së sipas autorizimeve respektive, në funksion të kryerjes së investimit për të cilën është dhënë dhe autorizimi i përjashtimit. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 61-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Departamenti i Akcizës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në bashkëpunim me Departamentin Teknik me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimeve tarifore të deklarimeve të kryera, të ndjekë përputhshmërinë ligjore të tyre sipas autorizimeve respektive me status përjashtimi nga pagesa e tvsh-së, sipas praktikave doganore të cituara në anekset nr. 16 dhe nr. 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit që lidhen me artikuj të natyrës “filtra”, “lubrifikantë”, “gjilpëra makinash”, “radio marrëse” me detyrime doganore të përjashtuara në shumën 3,195,478 lekë në funksion të kontabilizimeve dhe arkëtimeve të detyrimeve doganore.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Departamentin Operativ-Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të verifikojë vlerat dhe sasitë faktike gjatë kontrollit në terren pranë selive të operatorëve importues, të mallrave të deklaruara me status përjashtimi nga pagesa e TVSH-së sipas deklarimeve të kryera në autorizimet respektive që lidhen me praktikat doganore të cituara sipas aneksit nr. 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dhe për mospërputhjet e konstatuara në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe të veprojë për nxjerrjen dhe arkëtimin e gjithë detyrimeve doganore dhe tatimore.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rezultoi se nga 23 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 23 masa ose 100%, nga të cilat 11 masa janë zbatuar plotësisht ose 47.9%, 7 masa janë në proces zbatimi ose 30.4%, 2 masa janë zbatuar pjesërisht ose 8.7% dhe 3 masa nuk janë zbatuar ose 13%.

Janë rekomanduar 4 masa shpërblim dëmi në vlerën 91,274,257 lekë, janë pranuar 3 masa në vlerën 91,113,297 lekë ose 99.8%, nga të cilat 1 masë nuk është zbatuar, 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në vlerën 169,960 lekë nuk është pranuar. Në total janë marrë vendime për vlerën 1,774,495 lekë ose 1.9% të vlerës së rekomanduar.

Nga 21 masa disiplinore janë pranuar 21 masa ose 100%, nga të cilat 1 masë është zbatuar plotësisht ose 4.8%, 8 masa janë në proces zbatimi ose 38.1% dhe 12 masa nuk janë zbatuar ose 57.1%. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 14-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, të marrë të gjithat masat për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 76 raste në vlerën 89,339,040 lekë, nga subjektet sipas anekseve nr. 3,4,5,6,7,8,9 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 545/46, datë 26.09.2016.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të kryejnë kontabilizimin dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit në vlerën totale **prej 153,737,116 lekë**, si dhe kërkimin e sekuestrimit të vlerës së mjeteve me të cilët është kryer shkelja doganore e kontrabandës, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Hetimit lidhur me kryerjen e detyrave funksionale rezultuan dosje hetimore për të cilat nuk është kërkuar sekuestrimi i vlerës së mallit të cilësuar si objekt kontrabande në proces-verbalet e hartuara nga Drejtoria e Hetimit dhe dërguar më pas për nxjerrje vendimi administrativ pranë Degëve Doganore respektive si dhe veprime që kanë konkluduar në mosnxjerrje të vendimeve administrative nga Degët Doganore respektive veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289, 290 dhe nenit 291 të Kodit Doganor sipas ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 74-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Hetimit në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë dhe organe të tjera hetimore të ndjekin të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor bazuar në ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH” i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal” i ndryshuar me ligjin nr. 144/2013 datë 02.03.2013 ‘Kodi Penal në RSH’ i ndryshuar dhe gjithë legjislacionin penal në fuqi që lidhet me këto vepra penale, për të kërkuar sekuestrimin e mallrave objekt kontrabande dhe mjeteve me të cilin është kryer kontrabanda, si dhe të kërkojë nxjerrjen dhe kontabilizimin e vendimeve administrative për 15 raste/subjekte sipas aneksit nr. 21 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në shumën totale 85,799,334 lekë.

Brenda datës 30.09.2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Vlerës, Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore për unifikimin e metodologjisë së vlerësimit doganor të mallrave rezultoi se janë nisur shkresat respektive në Degët Doganore për rivlerësimin e artikujve, por nga Degët Doganore nuk ka patur reagime për rivlerësimin e praktikave doganore të cilat mbulojnë artikujt e importuar nga vendet jashtë Bashkimit Evropian, NEU (Kina) ashtu edhe artikujt e kuotuar në bursë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 33-37 të Kodit Doganor; Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke

ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **291 raste/subjekte** sipas anekseve nr. 8-12 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën **25,908,665 lekë**.

Brenda datës 30.09.2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit dhe Drejtoria Teknike e Akcizës rezultuan përjashtime nga detyrimet doganore të TVSH-së, jo në përputhje me kërkesat nenit 4.g, të ligjit nr. 125/2012 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar, nenit 56 pika 38/a të Ligjit nr 92/2014 datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", nenit 8, pika 1/a të VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014, Aneksit 4.1 të VKM-së nr. 13, datë 14.01.2015 si dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në RSH", datë 25.06.2012. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 61-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **15,938,558 lekë** për 29 raste/subjekte, sipas anekseve nr. 15-20 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe të kërkojë verifikimin e pagesave doganore të akcizës në shumën **1,368,773 lekë** për 5 raste/subjekte sipas aneksit nr. 17 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga ana e Drejtorisë së Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore rezultuan subjekte përfitues të autorizimeve të regjimit të lejimit të përkohshëm të cilët nuk i kanë dhënë destinacion doganor mallit sipas afateve të përcaktuara në këto regjime veprime këto jo në përputhje me kërkesat e neneve 35, 157-164, 256.2, 273 dhe 275 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe u konstatuan veprime të kryera jo në përputhje me shpjegimet dhe përcaktimet e nenit 54, titulli VI "Vlera Doganore" pika c, e VKM-së nr. 205 datë 13.04.1999 "Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" i ndryshuar, Pika 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007, në shumën totale **13,314,866 lekë** nga të cilat shuma prej 10,817,753 lekë detyrim dhe gjobë doganore për tu kontabilizuar dhe shuma prej 2,497,113 lekë lënë detyrë për ndjekje të arkëtimit të detyrimeve doganore deri në përfundim të autorizimit të regjimit të lejimit të përkohshëm. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 31-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 35 raste/subjekte, në vlerën totale **13,314,866 lekë** nga të cilat vlera prej 10,817,753 lekë detyrim dhe gjobë doganore për kontabilizim sipas anekseve nr. 1 3 dhe 4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe shuma prej 2,497,113 lekë lënë si detyrë për ndjekje të arkëtimit të detyrimeve doganore deri në përfundim të autorizimit të

regjimit të lejimit të përkohshëm nga 1(një) subjekt sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të praktikave juridike pranë Drejtorisë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në referim të procedurës ankimese për vendimet administrative të nxjerra më parë për shkelje administrative në fushën doganore u konstatua vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 231, 256, 261, 286, 287 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, jo në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 5883 datë 16.05.2006 të DPD sipas Shtojcës IV të Ligjit nr. 9590 datë 27.07.2006 dhe “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit ndërmjet RSH dhe KE dhe shteteve të tyre anëtare”, jo në përputhje me nenin 122 pika a, b, c të nenit 142 të VKM-së nr. 205. datë 13.04.199 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” si dhe pikës 1 dhe 2 të Nenit 87 të KD “Deklarata me shkrim”, me pasojë detyrime doganore të munguara dhe të pakontabilizuara në formën e gjobës doganore sipas legjislacionit në fuqi në 1(një) rast në shumën **906,772 lekë** dhe garanci doganore të pakontabilizuara në zbatim të nenit 202 deri 204 të Kodit Doganor në 2(dy) raste në shumën **337,118 lekë** për vendime të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 42-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për një vendim administrativ në shumën totale **906,772 lekë** për një subjekt duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e gjobës doganore bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës së garancisë doganore në shumën **337,118 lekë** si masë garancie doganore për verifikimin doganor të certifikatave lëvizëse EUR.1 të përfshira në praktikën doganore për dy vendime të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 sipas aneksit nr. 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Origjinës për administrimin e korrespondencës me Doganat Homologe të verifikimit të provave të origjinës rezultoi se për një periudhë 10 mujore nga data e kërkesës për verifikimin e dëshmimeve të origjinës, nga doganat homologe nuk ka ardhur përgjigje si ose ka ardhur përgjigje për prova origjine negative apo të falsifikuara. Nga sektori i origjinës për këto praktika, është përgatitur dokumentacioni për refuzimin e trajtimit preferencial, në përputhje me kërkesat e nenit 33.6 të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006, të MSA të RSH dhe KE, hyrë në fuqi më 01.04.2009; protokollin 4 lidhur me “Verifikimi i dëshmimeve të origjinës”, por Autoritetet Doganore respektive nuk kanë nxjerrë vendim administrativ referuar nenit 287 dhe 289 të Kodit Doganor. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 37-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët

e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **12 raste/subjekte**, në vlerën **3,430,205 lekë** sipas aneksit nr. 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm lidhur me ushtrimin e detyrave funksionale gjatë ushtrimit të detyrave funksionale në proceset e auditimit, në etapat e auditimit, janë marrë në konsideratë observacione në kundërshtim dhe shkelje të kërkesave të publikuara nga Ministria e Financave në Udhëzimin nr. 24, datë 11.09.2015 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007”, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor, si dhe mos evadim të materialeve të auditimit sipas afateve të përcaktuara në standardet e auditimit të përcaktuar në ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe MAB. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 112-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **11 raste/subjekte**, në vlerën **2,797,590 lekë** sipas aneksit nr. 22 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit të Pas Zhdoganimit lidhur me kryerjen e detyrave funksionale rezultoi keqklasifikim i shkeljes doganore nga autoriteti doganor kompetent gjatë procesit të vendimmarrjes me pasojë uljen e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.4, 271.1/2/a/b, 275.1, 261.2, 287 dhe 289 të Kodit Doganor. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 58-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **3 raste/subjekte**, në vlerën **2,000,631 lekë** sipas aneksit nr. 14 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Antikontrabandës lidhur me kryerjen e detyrave funksionale rezultoi se nuk janë dorëzuar procesverbale konstatimi për shkelje në fushën doganore pranë autoriteteve doganore kompetente, nuk janë përllogaritur saktë shumat e detyrimeve doganore për shkeljet e konstatuara si dhe në shumë raste nga Autoriteti Doganor Kompetent nuk është nxjerrë vendim administrativ, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.4 261.1, 28.1, 285.4, 287.1/2 dhe 289.1 të Kodit Doganor. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr.53-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **12 raste/subjekte**, në vlerën **1,687,371 lekë** sipas aneksit nr. 13 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2017

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e prokurimeve rezultoi se me shkresën nr. 20135/7 prot., datë 12.10.2016 është lidhur kontrata e furnizimit me shoqërinë “A.....” shpk. Afati i ekzekutimit të kësaj kontrate është nga dita e nënshkrimit të saj deri 31.12.2016. Nga Autoriteti Kontraktor, nuk është llogaritur penalitet për mos realizim të sasisë së zërave të riparimit dhe vlerës së kontratave me objekt “Për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej **247,233 lekë**, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit “Përfaqësimi i palëve” dhe “Sanksionet” të përcaktuara në kontratën e lidhur midis palëve, ku kontaktuesit detyrohen të paguajnë penalitet në masën 2/1000 në ditë për vlerën e pa realizuar të kontratës nga data e situacionit dhe faturës së fundit. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 154-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **247,233 lekë** nga subjekti “A.....” shpk.

Brenda datës 30.09.2017

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, për shkak të ristrukturimit të deklaruar në programin qeverisës nga Kryeministri, mbi bashkimin e dy institucioneve kryesore të administrimit të ardhurave, i rekomandojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave** që në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pasi të bëjë klasifikimin e tyre, sipas pikës 1, germa “b”, “c” dhe “ç” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

KRYETAR